

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 27.09.2025

1. Dickinson sh.a mban investime në dy entitete Di'Anno sh.a dhe Bayley sh.a. Pasqyrat e pozitës financiare të të tri entiteteve për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 janë dhënë më poshtë:

	Dickinson €'000	Di'Anno €'000	Bayley €'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>			
Prona, fabrika dhe paisjet	82,500	42,500	37,500
Investimet	<u>18,000</u>	<u>-</u>	<u>-</u>
	100,500	42,500	37,500
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>			
Stoqet	16,500	15,000	14,000
Të arkëtueshmet tregtare	21,500	15,000	15,500
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	<u>5,500</u>	<u>5,000</u>	<u>4,500</u>
Total pasuritë qarkulluese	43,500	35,000	34,000
Total pasuritë	144,000	77,500	71,500
<i>Ekuiteti:</i>			
Aksione të zakonshme €1.00 secila	35,000	25,000	25,000
Premia e aksioneve	20,000	-	-
Fitimet e mbajtura	<u>27,500</u>	<u>22,000</u>	<u>14,000</u>
	82,500	47,000	39,000
<i>Detyrimet afatgjata:</i>			
Kredia	25,000	12,500	11,000
Tatimi i shtyrë	<u>19,500</u>	<u>6,000</u>	<u>8,500</u>
Total detyrimet afatgjata	44,500	18,500	19,500
<i>Detyrimet afatrashkurta:</i>			
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	12,500	8,500	10,000
Tatimi aktual i pagueshëm	<u>4,500</u>	<u>3,500</u>	<u>3,000</u>
Total detyrimet afatrashkurta	17,000	12,000	13,000
Total ekuiteti dhe detyrimet	144,000	77,500	71,500

Informatat në vijim janë të rëndësishme:

- i) Më 1 janar 2024, Dickinson sh.a bleu 15 milionë aksione të zakonshme të Di'Anno sh.a-së për €8 milionë në para të gatshme dhe një shkëmbim aksionesh prej tre (3) aksionesh në Dickinson sh.a për çdo dy (2) aksione të blera në Di'Anno sh.a. Vetëm shpërblimi në para të gatshme është regjistruar nga Dickinson sh.a.

Në datën e blerjes, fitimet e mbajtura të Di'Anno sh.a-së ishin €17.5 milionë; ndërsa çmimi i tregut të aksioneve të Dickinson sh.a dhe Di'Anno sh.a ishte €4 dhe €2.4 përkatësisht.

- ii) Në datën e blerjes, vlerat e drejta të pasurive neto të Di'Anno sh.a-së ishin të barabarta me vlerën e tyre kontabël me përjashtim të:
- Tokës së pa-amortizueshme me vlerë kontabël prej €25 milionë që kishte një vlerë të drejtë prej €30 milionë.
 - Fabrikës me vlerë kontabël prej €10 milionë dhe një vlerë të drejtë që tejkalonte vlerën kontabël me €4 milion. Jeta e mbetur ekonomike e fabrikës më 1 janar 2024 ishte dy (2) vjet. Përdoret zhvlerësimi linear.
- iii) Dickinson sh.a bleu gjithashtu 10 milionë aksione në Bayley sh.a më 1 janar 2023 për një pagesë në para të gatshme prej €6 milionë, kur fitimet e mbajtura të Bayley sh.a-së ishin €7.5 milionë.
- iv) Stoqet e Di'Anno sh.a-së dhe Bayley sh.a-së përfshijnë mallra të blera nga Dickinson sh.a për €12 milionë dhe €10 milionë përkatësisht. Dickinson sh.a i furnizoi mallrat me kosto plus një marzhë prej 25% tek të dy kompanitë.
- v) Të arkëtueshmet tregtare të Dickinson sh.a përfshijnë €3 milionë të arkëtueshme nga Di'Anno sh.a dhe €1.5 milionë të arkëtueshme nga Bayley sh.a. Të pagueshmet tregtare të Di'Anno sh.a-së dhe Bayley sh.a-së përfshijnë shumat ekuivalente të pagueshme ndaj Dickinson sh.a.
- vi) Pjesa tjetër e investimeve në Dickinson sh.a është një investim prej 10% në një entitet tjetër që mbahet me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes. Vlera e drejtë e investimit më 31 dhjetor 2024 ishte €6.8 milionë.
- vii) Është politikë e grupit që interesi jo-kontrollues të matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes dhe çmimi i aksioneve të Di'Anno sh.a-së në atë datë mund të konsiderohet si përfaqësues i vlerës së drejtë të aksioneve të mbajtura nga interesi jo-kontrollues.
- viii) Një test dëmtimi i kryer më 31 dhjetor 2024 zbuloi se zëri i mirë pas blerjes së Di'Anno sh.a u dëmtua me €0.8 milionë dhe investimi në Bayley sh.a u dëmtua me €0.4 milionë.

Kërkohet:

Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të grupit Dickinson për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024. (30 pikë)

1.


Grupi Dickinson

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2024.

<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>	€'000
Zëri i mirë (L12)	69,700
Prona, fabrika dhe paisjet (82,500 + 42,500 + 5,000 + 4,000 - 2,000 L13)	132,000
Pasuritë financiare (L16)	6,800
Investimet në shoqërinë Bayley sh.a	<u>7,400</u>
	215,900
 <i>Pasuritë qarkulluese:</i>	
Stoqet (16,500 + 15,000 -2,400 L15)	29,100
Të arkëtueshmet tregtare (21,500+15,000-3,000 L15)	33,500
Paraja dhe ekuivalentët e parasë (5,500+5,000)	<u>10,500</u>
	73,100
 Total pasuritë	289,000
 <i>Ekuiteti:</i>	
Aksione të zakonshme €1.00 secila (35,000+22,500 L19)	57,500
Premia e aksioneve (20,000+67,500 L19)	87,500
Fitimet e mbajtura (L14)	31,280
Interesi jo-kontrollues (L18)	<u>23,720</u>
	200,000
 <i>Detyrimet afatgjata:</i>	
Kredia (25,000+12,500)	37,500
Tatimi i shtyrë (19,500+6,000)	<u>25,500</u>
	63,000
 <i>Detyrimet afatrashkurta:</i>	
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera (12,500+8,500-3,000 L15)	18,000
Tatimi aktual i pagueshëm (4,500+3,500)	<u>8,000</u>
	26,000
 Total ekuiteti dhe detyrimet	289,000

Llogaritjet (të gjitha shumat në €'000)

1. Struktura e grupit



2. Zëri i mire në blerjen e Di'Anno sh.a

	€'000
Konsiderata e blerjes:	
Paraja	8,000
Shkembimi i aksioneve (15,000/2 x 3 x €4)	90,000
Interesi jo-kontrollues në blerje (10,000 x €2.4)	<u>24,000</u>
	122,000
Minus vlera e drejtë e pasurive neto në blerje (L13)	<u>(51,500)</u>
Zëri i mire në blerje	70,500
Minus humbja nga dëmtimi	<u>(800)</u>
Zëri i mirë në datën e raportimit	69,700

3. Neto pasuritë e Di'Anno sh.a

Zëri	Në blerje €'000	Në raportim €'000	Ndryshimi €'000
Kapitali aksionar	25,000	25,000	-
Fitimet e mbajtura	17,500	22,000	4,500
Korigjimet e vlerës së drejtë:			
Toka	5,000	5,000	-
Fabrika	<u>4,000</u>	<u>2,000 *</u>	<u>(2,000)</u>
	51,500	54,100	2,500

*Zhvlerësimi i vlerës së drejtë të fabrikës = 4,000/2 vite = 2,000 në vit

4. Fitimet e mbajtura të grupit

	Dickinson sh.a	Di'Anno sh.a	Bayley sh.a
Sipas pyetjes	27,500	22,000	14,000
Minus FM para blerjes		<u>(17,500)</u>	<u>(7,500)</u>
		4,500	6,500
FPR - Di'Anno		(2,400)	
FPR - Bayley			<u>(2,000)</u>
Zhvlerësimi shtesë		(2,000)	
Dëmtimi i zërit të mirë		<u>(800)</u>	
		(700)	4,500
Përfitimi nga VD e pasurive financiare	2,800		
Pjesa e Dickinson në Di'Anno (60% x -700)	(420)		
Pjesa e Dickinson në Bayley (40% x 4,500)	1,800		
Humbja nga dëmtimi i investimit në shoqëri	<u>(400)</u>		
	31,280		

5. FPR në shitjen e mallrave

Dickinson sh.a te Di'Anno sh.a = 25/125 x 12,000=2,400

Debi	Fitimet e mbajtura te grupit	2,400	
Kredi	Stoqet e grupit		2,400
Dickinson tek Bayley sh.a = 40%x (25/125 x 10,000)			
Debi	Fitimet e mbajtura te grupit	800	
Kredi	VB e investimit në Bayley sh.a		800

6. Investimet tjera/Pasuritë financiare

	€'000
Total vlera e investimeve të Dickinson sh.a	18,000
Minus: konsiderata në para për Di' Anno sh.a	(8,000)
Minus: konsiderata në para për Bayley sh.a	<u>(6,000)</u>
Vlera e 10% investime në entitete tjera	4,000
Përfitimi nga vlera e drejtë	<u>2,800</u>
Vlera e drejtë në datën e raportimit	6,800

7. Vlera bartëse e investimit në shoqërinë Bayley sh.a

	€'000
Kosto e investimit	6,000
Pjesa e fitimeve pas blerjes (40% x 4,500 L12)	1,800
Dëmtimi i investimit në Bayley sh.a	<u>(400)</u>
	7,400

8. IJK në datën e raportimit

	€'000
IJK në blerje (L12)	24,000
Minus pjesa e humbjeve pas blerjes (40% x -700 L12)	<u>(280)</u>
	23,720

9. Vlerat e shkëmbimit të aksioneve

Numri i aksioneve te emetura si konsiderate e blerjes $= (15,000 / 2 \times 3) = 22,500$ aksione.

Te aksionet e zakonshme $(22,500 \times \text{€}1) = 22,500$

Te premia e aksioneve $(22,500 \times (\text{€}4 - \text{€}1)) = 67,500$

2.

a) Lindemann sh.a blen dhe shet mallra dhe asete në dollar amerikan (\$), por ka një valutë funksionale Euro (€). Më 1 korrik 2024, Lindemann sh.a bleu mallra për \$50,000. Në fund të vitit të Lindemann sh.a më 31 dhjetor 2024, kjo shumë mbetet e papaguar.

Më 1 korrik 2024, Lindemann sh.a shiti mallra me kredi për \$400,000. Më 1 gusht 2024, Lindemann sh.a mori \$200,000 nga klienti. Pjesa e mbetur prej \$200,000 është e papaguar më 31 dhjetor 2024.

Kurset përkatëse të këmbimit janë:

1 korrik 2024	\$5.0 = €1
1 gusht 2024	\$5.7 = €1
31 dhjetor 2024	\$6.5 = €1

Kërkohet:

Shpjegojini Lindemann sh.a trajtimin e kërkuar kontabël të transaksioneve të mësipërme në pajtim me SNK 21 *Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit*, duke treguar shumat që duhen raportuar në pasqyrat e saj financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024.

(5 pikë)

b) Më 1 korrik 2024, Forge sh.a dorëzoi dhe instaloi kompjuterë tek një nga klientët e saj për një pagesë të menjëhershme prej €6 milionë. Në çmimin e shitjes përfshihej një kontratë dy (2) vjeçare shërbimi, e cila do t'i kushtojë Forge sh.a-së €0.6 milionë për ta përfunduar. Forge sh.a ofron shërbimin e saj me një marzhë mbi kosto prej 25% për të gjithë klientët. Vlera e shitjes së instalimit ishte €0.25 milion e cila gjithashtu është përfshirë në çmimin e shitjes.

Kërkohet:

Shpjegoni drejtorëve të Forge sh.a efektin e transaksionit të mësipërm në pajtim me SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët në pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024.*

(5 pikë)

[Total 10 pikë]

2.

a)

Kontabiliteti për këto transaksione trajtohet nga SNK 21 *Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit*. Meqenëse Lindemann sh.a ka një valutë funksionale të Euros, transaksionet do të duhet të regjistrohen në Euro. Zërat monetarë kërkojnë ripërkthim pas shlyerjes së bilancit dhe në fund të periudhës raportuese për të përcaktuar humbjet dhe fitimet nga këmbimi.

Blerja e mallrave më 1 korrik 2024 do të njihej në blerje dhe llogari të pagueshme tregtare me vlerë €10,000 (\$50,000/5.0).

Në datën e raportimit, shuma mbeti e papaguar, prandaj një pagesë do të rillogaritej si €7,692 (\$50,000/6.5) që do të raportohet nën detyrimet afatshkurta në pasqyrën e pozitës financiare. Prandaj, një fitim nga këmbimi prej €2,308 (€10,000 - €7,692) njihet dhe do të kreditohet në fitim ose humbje.

Për shitjet më 1 korrik 2024, transaksioni do të përkthehet me kursin e këmbimit spot, pra një vlerë e shitjeve dhe të arkëtueshmeve prej €80,000 (\$400,000/5.0).

Më 1 gusht, një klient pagoi gjysmën e vlerës së shitjes, një shumë prej €35,087 (\$200,000/5.70) në vend të €40,000 (\$200,000 /5.0) që mund të ishte marrë nëse shitja do të ishte paguar pikërisht në datën e transaksionit. Në datën e marrjes së parave, ndodhi një humbje nga këmbimi prej €4,913 që do të debitohej në fitim ose humbje.

Bilanci i të arkëtueshmes prej \$200,000, i cili mbeti i papaguar (arkëtuar) më 31 dhjetor 2024, do të përkthehej në €30,769 (\$200,000/6.5). Do të ishte vlerësuar në €40,000 (\$200,000/5.0) nëse nuk do të kishte pasur ndryshime në kurset e këmbimit. Bilanci i ripërkthyer, pra, rezulton në një humbje nga këmbimi prej €9,231 (€40,000 - €30,769).

b)

Transaksioni do të kontabilizohet duke përdorur SNRF 15 *Të Hyrat nga kontratat me klientët*. Kjo shitje është një shitje në pako pasi që përfshin edhe shërbimin dhe njohja varet nëse detyrimet e performancës janë përmbushur në një moment kohor apo përgjatë kohës.

Për furnizimin e kompjuterëve, vlera e shitjes prej €5 milionë [€6 milionë - (125/100 × €0.6 milionë) - €0.25 milionë] do të njihet plotësisht për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024.

Vlera e shitjes së instalimit prej €0.25 milionë do të njihet në mënyrë të njëjtë plotësisht pas instalimit për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024.

Megjithatë, vlera e shitjes së shërbimit do të njihet në masën që detyrimet e performancës janë përmbushur. Në këtë rast, €0.75 milionë (0.6 × 1.25) është për dy vjet, deri më 31 dhjetor 2024, vetëm gjashtë (6) muaj detyrim shërbimi do të duhej të njihej si pjesë e të ardhurave në pasqyrën e fitimit ose humbjes në shumën prej €0.1875 milionë (6/24 × €0.75 milionë). Bilanci total prej €0.5625 milionë do të ndahej në detyrime afatshkurter prej €0.375 (12/24 × 0.750 milionë) dhe detyrime afatgjata prej €0.1875 (0.5625-0.375).

3. Bilanci vërtetues i mëposhtëm lidhet me Osbourne sh.a, një kompani e përfshirë në furnizimin dhe instalimin e kompjuterëve dhe aksesorëve përkatës për organizata të ndryshme.

Bilanci vërtetues i Osbourne sh.a me 31 dhjetor 2024

	Debi	Kredi
	€'000	€'000
Të hyrat		70,800
Kosto e shitjeve	51,716	
Shpenzimet e shpërndarjes	304	
Shpenzimet administrative	792	
Interesi i kredisë i paguar	192	
Prona investuese	70,000	
Prona sipas koston e blerë me 1 janar 2021 (16 vite jetë të dobishme)	8,000	
Zhvlerësimi i akumuluar i pronës me 1 janar 2024		1,500
Fabrika dhe paisjet sipas koston	6,744	
Zhvlerësimi i akumuluar i fabrikës dhe paisjeve me 1 janar 2024		1,944
Licenca sipas koston	1,600	
Amortizimi i akumuluar i licences me 1 janar 2024		640
Kredia me 12% interes e marrë me 1 janar 2024		1,600
Tatimi aktual		800
Fitimet e mbajtura me 1 janar 2024		50,458
Tatimi i shtyrë		400
Akzionet e zakonshme prej €1 secila		28,000
Premia e aksioneve		500
Të arkëtueshmet tregtare	12,730	
Të pagueshmet tregtare		1,408
Banka		780
Stoqet me 31 dhjetor 2024	1,752	
Qiraja/lizingu i paguar	<u>5,000</u>	<u> </u>
	158,830	158,830

Informata shtesë:

- i) Osbourne sh.a vendosi të rivlerësojë pronën e saj për herë të parë më 1 janar 2024. Drejtorët pranuan një raport të një vlerësuesi të pavarur i cili e përcaktoi vlerën e drejtë të pronës së zotëruar në €5.98 milionë në atë datë. Osbourne sh.a nuk e kishte kontabilizuar ende rivlerësimin. Në juridiksionin tatimor të Osbourne sh.a, rivlerësimi nuk shkakton detyrim tatimor të shtyrë. Prona zhvlerësohet në bazë lineare.
- ii) Më 1 janar 2024, Osbourne sh.a bleu të drejtën për të përdorur një pasuri, një fabrikë, sipas një marrëveshjeje që përmbush përkufizimin e një qiraje sipas SNRF 16 *Lizingjet*. Pagesat e qirasë në bilancin vërtetues përfaqësojnë një pagesë fillestare prej €1 milion të paguar më 1 janar 2024 dhe qiranë e parë vjetore prej €4 milionë të paguar më 31 dhjetor 2024. Marrëveshja e qirasë kërkon edhe 4 pagesa të tjera vjetore prej €4 milionë secila më 31 dhjetor nga 2025 deri në vitin 2028. Vlera e tanishme e pagesave të ardhshme të qirasë (pa përfshirë pagesën fillestare) në fillim të qirasë ishte €13.2 milionë. Jeta e dobishme e fabrikës është shtatë (7) vjet. Norma e interesit e nënkuptuar

në lizing nuk është e përcaktueshme lehtësisht, por norma shtesë (rritëse) e huamarrjes së Osbourne sh.a është 8%.

Fabrika dhe pajisjet (përveç fabrikës të marrë me qira) zhvlerësohen me 20% në vit në bazë të saldosh zbritëse.

Nuk është llogaritur ende asnjë zhvlerësim për asnjë pasuri jo-qarkulluese për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024. I gjithë amortizimi dhe zhvlerësimi i pasurive jo-qarkulluese i ngarkohet kostos së shitjeve duke përfshirë edhe humbjet nga dëmtimi.

- iii) Më 1 janar 2024, drejtorët e Osbourne sh.a vendosën të shisnin një fabrikë në pronësi të tyre dhe pasuria përmbushte kriteret për t'u klasifikuar si e mbajtur për shitje në atë datë. Fabrika kishte kushtuar €2 milionë dhe kishte një vlerë kontabël prej €1.2 milionë në 1 janar 2024. Në atë datë, vlera e drejtë minus kostot e shitjes ishte €0.8 milionë. Nuk ishin bërë rregullime për të regjistruar këtë klasifikim në bilancin e mësipërm vërtetues. Më 31 dhjetor 2024, vlera e drejtë minus kostot e shitjes nuk kishte ndryshuar nga ajo që ishte në fillim. Fabrika është ende në pronësi të Osbourne sh.a më 31 dhjetor 2024.
- iv) Prona investuese në bilancin vërtetues u regjistrua duke përdorur modelin e vlerës së drejtë të SNK 40 *Prona Investuese*. Vlera në bilancin vërtetues ishte vlera e drejtë më 1 janar 2024. Vlera e drejtë më 31 dhjetor 2024 ishte €73.5 milionë.
- v) Stoqet tregtarë të kompjuterëve dhe aksesorëve më 31 dhjetor 2024 përfshinin artikuj me një kosto prej €72,000. Për të shitur këto artikuj, atyre u duhet një proces shtesë që kushton €2,000, në të cilin pikë stoqet mund të shitet për €68,000. Këta artikuj ishin përfshirë me kosto në bilancin vërtetues.
- vi) Licenca amortizohet në bazë lineare me normën 10% në vit. Nuk është llogaritur ende asnjë amortizim për vitin deri më 31 dhjetor 2024.
- vii) Më 20 dhjetor 2024, drejtorët e Osbourne sh.a deklaruan një dividend prej €0.20 për aksion. Nuk u paguan dividendë gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2024.
- viii) Kërkohej një provizion i tatimit mbi të ardhurat për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024 prej €8.6 milionë. Bilanci i tatimit aktual përfaqëson nën/mbi-provizionin e detyrimit tatimor për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023. Më 31 dhjetor 2024, baza tatimore e pasurive neto të Osbourne sh.a ishte €9 milionë më pak se vlerat e tyre kontabël. Norma e tatimit mbi të ardhurat e Osbourne sh.a është 25%.
- ix) Kredia me interes prej 12% shfaqet me vlerën e saj nominale në datën e marrjes. Kredia do të paguhet më 31 dhjetor 2026 me një premi të konsiderueshme. Norma efektive e interesit është 14%.

Kërkohet:

- a) Përgatitni pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për Osbourne sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024. (9 pikë)
- b) Përgatitni pasqyrën e pozitës financiare për Osbourne sh.a më 31 dhjetor 2024. (11 pikë)

[Total: 20 pikë]

3.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të Osbourne sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024.**

	€'000
Të hyrat	70,800
Kosto e shitjeve (L16)	<u>(56,822)</u>
Fitimi bruto	13,978
Shpenzimet administrative	(792)
Shpenzimet e shpërndarjes	<u>(304)</u>
Fitimi operativ	12,882
Kosto financiare (1,056 L12 + 224 L17)	(1,280)
Përfitimi nga vlera e drejtë e pronës investuese (L18)	<u>3,500</u>
Fitimi para tatimit	15,102
Tatimi në fitim (L19)	<u>(9,650)</u>
Fitimi për vitin	5,452

Pasqyra e pozitës financiare të Osbourne sh.a më 31 dhjetor 2024

	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>	
Pasuritë e paprekshme (L14)	800
Prona, fabrika dhe paisjet (5,520 + 2,880 + 11,360)(L11)	19,760
Prona investuese (L18)	<u>73,500</u>
	94,060
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>	
Stoqet (L15)	1,746
Të arkëtueshmet tregtare	12,730
Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera (L13)	<u>800</u>
	15,276
Total pasuritë	109,336
<i>Ekuiteti:</i>	
Akzionet e zakonshme prej €1 secila	28,000
Premia e aksioneve	500
Fitimet e mbajtura (50,458 + 5,452-[28,000 x €0.20])	<u>50,310</u>
	78,810
<i>Detyrimet afatgjata:</i>	
Kredia 12% (L17)	1,632
Detyrimi ndaj lizingut (L12)	7,076
Tatimi i shtyrë (L19)	<u>2,250</u>
	10,958
<i>Detyrimet afatshkurta:</i>	
Të pagueshmet tregtare	1,408
Mbitërheqja bankare	780
Detyrimi ndaj lizingut (L12)	3,180
Dividenda e pagueshme (L110)	5,600
Tatimi aktual i pagueshëm (L19)	<u>8,600</u>
	19,568
Total ekuiteti dhe detyrimet	109,336

Llogaritjet

1. Prona, fabrika dhe paisjet

	Prona	Fabrika & Paisjet	PMP
	€'000	€'000	€'000
Kosto/vlerësimi s/fillim	8,000	6,744	14,200
Minus zhvlerësimi i akumuluar	<u>(1,500)</u>	<u>(1,944)</u>	<u>-</u>
Vlera bartese s/fillim	6,500	4,800	14,200
Rivlerësimi	<u>(520)</u>	<u>-</u>	<u>-</u>
Shumat e rivlerësuara	5,980	4,800	14,200
PJQ të mbajtura për shitje	<u>-</u>	<u>(1,200)</u>	<u>-</u>
Shumat e zhvlerësueshme	5,980	3,600	14,200
Shpenzimet e zhvlerësimit:			
Prona (5,980/13)	(460)		
Fabrika dhe paisjet (20% x 3,600)		(720)	
PMP (14,200/5 vite)			<u>(2,840)</u>
Vlera bartese me 31 dhjetor 2024	5,520	2,880	11,360

2. Fabrika e marrë me qira

	€'000
<i>PMP matja fillestare</i>	
VT e pagesave të ardhshme	13,200
Plus: pagesa fillestare	<u>1,000</u>
Total	14,200
Zhvlerësimi (14,200/5 vite) =	<u>(2,840)</u>
PMP vlera bartëse	€11,360

Detyrimi ndaj lizingut:

Saldo në fillim	interesi 8%	Pagesa e qirasë	Saldo në fund
€'000	€'000	€'000	€'000
13,200	1,056	(4,000)	10,256
10,256	820	(4000)	7,076

Kosto financiare 2024	1,056
Detyrimet afatgjata	7,076
Detyrimet afatshkurta (10,256-7,076)	3,180

3. Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje

€'000

Pasuria jo-qarkulluese e mbajtur për shitje dhe operacioni i ndërprerë duhet të largohet nga pasuritë jo-qarkulluese nga data e klasifikimit dhe të riklasifikohet si një pasuri qarkulluese. Nga data e klasifikimit, pasuria nuk duhet të zhverësohet pasi nuk do të klasifikohet më si pasuri jo-qarkulluese. Ajo duhet të mbahet në libra me vlerën e saj më të ulët midis vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes nga data e klasifikimit.

Prandaj, vlera kontabël = €1,200

Vlera e drejtë minus kostot = €800 dhe pasuria duhet të mbahet në €800, ndërsa diferenca prej €400 do të njihet si humbje nga dëmtimi në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

4. Licenca	€'000
Kosto s/fillim	1,600
Minus amortizimi i akumuluar	(640)
Minus amortizimi i vitit	<u>(160)</u>
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2024	800

5. Stoqet	€'000
Sipas bilancit vertetues	1,752
Minus diferenca ndërmjet koston dhe VNR	<u>(6)</u>
Vlera e rishikuar	1,746
Kosto e stoqeve	72
Vlera neto e realizueshme (68-2)	66

6. Kosto e shitjeve	€'000
Sipas bilancit vërtetues	51,716
Korigjimi i stoqeve (L15)	6
Shpenzimet e zhvlerësimit:	
Prona (L1)	460
Fabrika(L11 dhe 2) [720+2,840]	3,560
Humbja nga rivlerësimi i pronës	520
Humbja nga dëmtimi i pasurise se mbajtur për shitje	400
Amortizimi i licences	<u>160</u>
	56,822

7. 12% kredi

Saldo në fillim	interesi efektiv 14%	Interesi i paguar	Saldo në fund
€'000	€'000	€'000	€'000
1,600	224	(192)	1,632

8. Prona investuese	€'000
Vlera e drejtë s/fillim	70,000
Përfitimi nga vlera e drejtë	<u>3,500</u>
Vlera e drejtë s/fund	73,500

9. Tatimi i pagueshem

	€'000
Saldo ne fillim:	
Aktual	800
I shtyrë	400
Në fund:	
Aktual	8,600
I shtyrë (9,000 x 25%)	2,250
Shpenzimi i tatimit saldo balancuese (2,250 + 8,600 - 400 - 800)	9,650

10. Dividenda e pagueshme	€'000
28,000 aksione x €0.20 =	€5,600

4. Ju punoni për një firmë konsulence, Anselmo sh.a, e cila ofron këshilla për investitorët e mundshëm në shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Besimi në efikasitetin dhe efektivitetin operativ të secilës kompani përcaktohet duke llogaritur dhe interpretuar koeficientët e mëposhtëm:

1. Marzha e fitimit bruto
2. Marzha e fitimit operaitv
3. Koeficienti i shpejtë ose testi acidik
4. Periudha e qarkullimi të stoqeve
5. Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme
6. Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme

Një investitor potencial kërkon këshillën tuaj se në cilën kompani të investojë midis Diembag sh.a dhe Vinnie sh.a, të dyja janë furnizues të pajisjeve të minierave. Më poshtë janë pasqyrat e tyre financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024:

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor:

	Diembag sh.a	Vinnie sh.a
	2024	2024
	€'000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>		
Toka dhe ndërtesat	500	300
Paisjet motorike	80	35
Fabrika dhe makineria	<u>325</u>	<u>185</u>
	905	520
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>		
Stoqet	105	100
Të arkëtueshmet tregtare	445	375
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	<u>230</u>	<u>170</u>
	<u>780</u>	<u>645</u>
	1,685	1,165
<i>Ekuiteti:</i>		
€1.00 Aksione të zakonshme	500	300
Teprica e rivlerësimit	240	150
Fitimet e mbajtura	<u>305</u>	<u>130</u>
	1,045	580
<i>Detyrimet afatgjata:</i>		
12% Nota kreditore	280	200
Tatimi i shtyrë	<u>30</u>	<u>10</u>
	310	210
<i>Detyrimet afatrashkurta:</i>		
Të pagueshmet tregtare	240	290
Tatimi aktual	<u>90</u>	<u>85</u>
	<u>330</u>	<u>375</u>
	1,685	1,165

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

	Diembag sh.a	Vinnie sh.a
	€'000	€'000
Të hyrat	2,830	1,605
Kosto e shitjes	<u>(540)</u>	<u>(480)</u>
Fitimi bruto	2,290	1,125
Shpenzimet administrative	(420)	(135)
Kosto e shpërndarjes	(270)	(102)
Shpenzimet tjera operative	<u>(165)</u>	<u>(118)</u>
Fitimi operativ	1,435	770
Kosto financiare	(120)	(40)
Të ardhurat nga investimet	<u>40</u>	<u>10</u>
Fitimi para tatimit	1,355	740
Shpenzimet e tatimit në fitim	<u>(145)</u>	<u>(105)</u>
Fitimi neto	1,210	635
<i>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</i>		
Terprica e rivlerësimit	<u>105</u>	<u>(30)</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	1,315	605

Kërkohet:

- a) Llogaritni koeficientët e paraqitura në pikat 1 deri në 6 më sipër për të dy kompanitë. (12 pikë)
- b) Komentoni mbi performancën e secilës kompani në aspektin e rentabilitetit, likuiditetit dhe efikasitetit të operacioneve. (8 pikë)

[Total: 20 pikë]

4.**(a)**

	Diembag sh.a	Vinnie sh.a
Marzha e fitimit bruto = Fitimi bruto / Shitjet x 100		
= 2,290 / 2,830 x 100	80.9%	
= 1,125 / 1,605 x 100		70.1%
Marzha e fitimit operativ = Fitimi operativ / Shitjet x 100		
= 1,435 / 2,830 x 100	50.71%	
= 770 / 1,605 x 100		47.98%
Koeficienti i shpejtë = (PQ - Stoqet) / Detyrimet afatrashkurta		
= (780 -105) / 330	2.04 : 1	
= (645 -100) / 375		1.45 : 1
Periudha e qarkullimi të stoqeve = Stoqet / Kosto e shitjeve x 365		
= 105 / 540 x 365	71 ditë	
= 100 / 480 x 365		76 ditë
Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme = Të arkëtueshme / Shitjet x 365		
= 445 / 2,830 x 365	57 ditë	
= 375 / 1,605 x 365		85 ditë
Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme = Të pagueshme / Kosto e shitjeve x 365		
= 240 / 540 x 365	162 ditë	
= 290 / 480 x 365		220 ditë

(b)

Bazuar në koeficientët e llogaritur, të dyja kompanitë duket se po bëjnë fitime të mëdha, ndoshta sepse teknologjia e produktit (pajisjet e minierave) është e re dhe në fazën e saj të rritjes. Kompanitë mund të përballojë të vendosin çmime premium. Megjithatë, Diembag sh.a ka më shumë shpenzime operative krahasuar me Vinnie sh.a, siç mund të shihet në ulen e marzhës së fitimit operativ. Diembag sh.a ka një likuiditet më të mirë sepse kontrolli i tyre i kreditit siguron që ata të mbledhin nga klientët brenda 2 muajve (57 ditë) nga shitjet me kredi. Për këtë arsye, ata gjithashtu mund të arrijnë të paguajnë furnitorët brenda 3 muajve (162 ditë). Nga ana tjetër, Vinnie sh.a ka probleme me likuiditetin; nuk është çudi që Vinnie sh.a, kërkon më shumë kohë për të paguar furnitorët sepse nuk mbledhin detyrimet e tyre nga klientët në periudh më të shkurtër.

5.

a) Drejtorët e Tankian sh.a ju kanë paraqitur 3 propozime për politikat e tyre të propozuara të kontabilitetit për zëra të ndryshëm të pasqyrave financiare për tu shqyrtuar nga ju:

Propozimi 1

Stoqet do të maten gjithmonë sipas kostos.

Propozimi 2

Nuk do të ketë amortizim të pasurive të paprekshme.

Propozimi 3

Ndryshimi në normën e zhvlerësimit nga 20% në 25% do të zbatohet në mënyrë retroaktive.

Kërkohet:

Vlerësoni përshtatshmërinë e politikave të propozuara të kontabilitetit më sipër. (3 pikë)

b) Araya sh.a përgatit pasqyrat financiare me 31 dhjetor çdo vit dhe zakonisht autorizon pasqyrat financiare për publikim më 25 shkurt të vitit pasues. Më 15 janar 2025 pra para autorizimit për publikim, Araya sh.a mori njoftim për një padi ligjore të ngritur nga Steele sh.a, një klient, për humbje fitimesh që dyshohet se është shkaktuar nga furnizimi i mallrave me defekt nga Araya sh.a për Steele sh.a më 30 tetor 2024. Shuma e kërkuar nga Steele sh.a ishte €5 milionë.

Drejtorët e Araya sh.a kanë vlerësuar rezultatet e mëposhtme në lidhje me këtë padi ligjore:

- Gjasa prej 28% që padia të mos ketë sukses.
- Gjasa prej 45% që padia të ketë sukses dhe Steele sh.a do të marrë dëmshpërblim prej €3.2 milionë.
- Gjasa prej 27% që padia të ketë sukses dhe Steele sh.a do të marrë dëmshpërblim prej €5 milionë.

Kërkohet:

Në përputhje me SNK 37 Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente dhe SNK 10 Ngjarjet pas periudhës raportuese shpjegoni se si duhet të kontabilizohet dhe raportohet kjo ngjarje në pasqyrat financiare të Araya sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024. (5 pikë)

c) SNK 23 Shpenzimet e huamarrjes përcakton kushtet sipas të cilave shpenzimet e huamarrjes duhet të kapitalizohen ose të llogariten si shpenzime. Më 1 janar 2024, Kilmister sh.a filloi ndërtimin e një fabrike për përdorim vetjak. Në të njëjtën datë, mori një kredi prej €40 milionë me interes 5% në vit. Të gjitha të ardhurat nga kreditë u përdorën menjëherë për të paguar token dhe për të blerë materiale ndërtimi për projektin. Punimet e ndërtimit filluan më 1 mars 2024 dhe vazhduan gjatë gjithë vitit, përveç një pushimi gjysmëmujor në maj 2024 dhe një pushimi tjetër gjysmëmujor në dhjetor 2024.

Kërkohet:

- i) Tregoni kushtet në të cilat shpenzimet e huamarrjes mund të kapitalizohen. (2 pikë)**
- ii) Llogaritni shumat që duhet të kapitalizohen si shpenzime të huamarrjeje për vitin financiar që përfundon me 31 dhjetor 2024. (4 pikë)**

d) SNK 2 *Stoqet* përshkruan trajtimin kontabël për stoqet dhe ofron udhëzime mbi përcaktimin e kostos dhe njohjen e mëvonshme si shpenzim, duke përfshirë çdo rënie të vlerës neto të realizueshme.

Stoqet në fund të Davis sh.a më 31 dhjetor 2024 ishin €345,000. Kjo përfshin €4,600 për artikujt e shkatërruar aksidentalisht më 31 dhjetor 2024 pasi u përfundua numërimi. Gjithashtu përfshin stoqe me kosto €2,900 të dëmtuar në tetor 2024, të cilat mund të ripërpunohen me një kosto prej €600 dhe të cilat më pas mund të shitet për €2,400.

Kërkohet:

- i) **Identifikoni 4 (KATËR) situata në të cilat vlera neto e realizueshme ka të ngjarë të jetë më e vogël se kostoja.** (2 pikë)
- ii) **Llogaritni vlerën në fund të stoqeve më 31 dhjetor 2024 dhe tregoni se si duhet të kontabilizohet në pasqyrën e pozitës financiare dhe në pasqyrën e fitimit ose humbjes.** (4 pikë)

[Total 20 pikë]

5.

(a)

Përshtatshmëria e politikave të kontabilitetit të propozuara

SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet në kontabilitet dhe gabimet* aplikohet në përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit, duke marrë në konsideratë ndryshimet në vlerësime dhe duke reflektuar korrigjimet e gabimeve të periudhave të mëparshme. Standardi kërkon pajtueshmëri me çdo SNRF specifike që zbatohet për një transaksion, ngjarje ose kusht, dhe ofron udhëzime për zhvillimin e politikave kontabël për zëra të tjerë që rezultojnë në informacion të rëndësishëm dhe të besueshëm. Megjithatë, Tankian sh.a lejohet të përdorë gjykimin kur një transaksion, ngjarje ose kusht nuk mbulohet në mënyrë të mjaftueshme nga standardet e kontabilitetit ose kur mendon se pajtueshmëria e plotë me një standard të caktuar të kontabilitetit do t'i bëjë pasqyrat financiare aq mashtroese sa do të binte ndesh me objektivin e pasqyrave financiare të përcaktuara në Kornizë.

Stoqet

Parimi themelor i SNK 2 *Stoqet* është që stoqet duhet të maten me vlerën më të ulët midis kostos ose vlerës neto të realizueshme. Kështu, mbajtja e stoqeve vetëm me kosto mund të jetë në konflikt me parimin themelor. Megjithatë, nëse drejtorët besojnë fuqimisht se mallrat me të cilat do të merret Tankian sh.a do të kenë gjithmonë një vlerë neto të realizueshme më të lartë, atëherë politika mund të mos ndikojë negativisht në matjen e stoqeve. Për më tepër, politika mund të jetë e pranueshme nëse mallrat do të furnizohen vetëm nga Tankian sh.a; domethënë nëse kompania do të jetë monopoliste. Në këtë rast, kompania do të jetë gjithmonë e sigurt se do të shesë mbi koston e saj.

Pasuritë e paprekshme

Amortizimi i pasurive e paprekshme gjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme duhet të pasqyrojë modelin në të cilin përfitimet ekonomike pritet të mirren nga Tankian sh.a, megjithëse metoda lineare është një parazgjedhje. Për më tepër, klasifikimi i pasurive të paprekshme në jetë të pakufishme dhe jetë të kufizuar do të përcaktojë nëse pasuria i nënshtrohet amortizimit. Nëse Tankian sh.a i klasifikon pasuritë e saj të paprekshme me jetë të pakufishme të përdorimit, atëherë nuk do të kërkohej amortizim. Megjithatë, nëse ato klasifikohen me jetë të kufizuar, atëherë do të duhet t'i amortizojnë ato. Kështu, politika do të jetë në përputhje me dispozitat e SNK 38 *Pasuritë e paprekshme* vetëm kur Tankian sh.a do të ketë vetëm pasuri të paprekshme të klasifikuara me jetë të pakufishme të përdorimit, në të cilin rast duhet të testohen për dëmtim të paktën një herë në vit.

Ndryshimi në normën e zhvlerësimit

SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet në kontabilitet dhe gabimet* përcakton se ndryshimet në politikat e kontabilitetit dhe korrigjimet e gabimeve në përgjithësi aplikohen në mënyrë retroaktive, ndërsa ndryshimet në vlerësimet kontabël në përgjithësi aplikohen në mënyrë prospektive.

Ndryshimi në normën e zhvlerësimit (20% deri në 25%) i referohet një ndryshimi në vlerësimin kontabël. Prandaj, duhet të aplikohet në mënyrë prospektive. Nga ana tjetër, nëse Tankian sh.a harron të ngarkojë zhvlerësimin në pasqyrat financiare të periudhës paraprake, atëherë ky gabim do të kontabilizohet, pra korigjohet në mënyrë retrospektive.

b)

Rasti duhet të trajtohet në përputhje me SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente* dhe SNK 10 *Ngjarjet pas Periudhës Raportuese*. SNK 37 kërkon që një entitet të ndajë një provizion për pagesat e ardhshme nëse dhe vetëm nëse entiteti ka një detyrim aktual që rrjedh nga një ngjarje e kaluar detyruese që ka shumë të ngjarë të rezultojë në dalje të një shume që mund të matet me besueshmëri.

Në rastin e këtij procesi gjyqësor kundër Araya sh.a, ekziston një probabilitet prej 72% (45% + 27%) që Araya sh.a do ta humbasë çështjen. Prandaj, duhet të krijohet një provizion me kusht që të mund të bëhet një matje e besueshme.

Kjo pavarësisht faktit se njoftimi i kërkesës është marrë pas përfundimit të periudhës aktuale. Në përputhje me SNK 10, marrja e njoftimit të kërkesës ligjore është një ngjarje korrigjuese pasi kjo ngjarje ofron prova për një gjendje (furnizim me mallra me defekt) që ekzistonte deri në datën e raportimit.

Shuma e provizionit të kërkuar duhet të pasqyrojë vlerësimin më të mirë të pagesës së ardhshme. Një vlerësim i tillë mund të dëshmohet nëpërmjet përvojës së kaluar të vetë subjektit ose mendimit të një eksperti (një shembull është këshilla e avokatit).

Kur matet një detyrim i vetëm si në rastin e këtij rasti gjyqësor, bëhet provizion i plotë për rezultatin më të mundshëm. Prandaj, duhet të bëhet një provizion prej €3.2 milionë; i debituar në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin 2024 dhe i kredituar në provizion si detyrim në pasqyrat e vitit që përfundon me 31 dhjetor 2024.

c)

- i) Sipas SNK 23 *Shpenzimet e huamarrjes*, tri ngjarje apo transaksione duhet të ndodhin në mënyrë që të fillojë kapitalizimi i shpenzimeve të huamarrjes.
 - a) Shpenzimi në pasuri ka ndodhur
 - b) Shpenzimet e huamarrjes kanë ndodhur
 - c) Aktivitetet janë në zhvillim e sipër për prëgatitjen e pasurisë për qëllimin e synuar apo për shitje.
- ii) Këtu, (a) dhe (b) më sipër po zhvillohen gjatë gjithë vitit. Aktivitetet e ndërtimit nuk po zhvilloheshin për gjysmen e majit 2024 dhe për gjysmen e dhjetorit 2024, pra për 1 muaj pushim. Prandaj, kishte 9 muaj aktivitet, dhe $9/12$ e shpenzimeve të interesit duhet të kapitalizohet. $5\% \times €40 \text{ milionë} \times 9/12 = €1.5 \text{ milionë}$

d)

- i) Ne mund të identifikojmë këto situatat kryesore në të cilat vlera neto e realizueshme ka mundësi të jetë më e ultë së kosto, dmth. kur ekziston:
 - a) Rritje e kosto ose rënie në çmimin e shitjes
 - b) Parregullësi fizike në gjendjen e stoqeve
 - c) Produkte të vjetruara
 - d) Vendimi si pjesë e strategjisë së marketingut së kompanisë për të prodhuar dhe shitur produktet me humbje
 - e) Gabime në prodhim ose blerje
- ii) Stoqet në fund €

Total stoqet		345,000
Të shkatërruara aksidentalisht		(4,600)
Të dëmtuara në tetor 2024	(2,900)	
VNR - Çmimi shitës minus kosto e shitjes (2,400 - 600)	<u>1,800</u>	
Shlyrja e stoqeve		<u>(1,100)</u>
Vlera e stoqeve në fund në PPF		339,300
Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar 31 dhejtor 2024		€
Kosto e shitjes:		
Shlyrja e stoqeve (4,600 + 1,100)		(5,700)